

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 31.07.2025, merr:

VENDIM NR.43/2025/KG

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDËRPRERJEN E ANEKSIT III TË KONTRATËS NR.2345/23 TË DATËS 01.06.2023 PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE

Neni 1

Jepet pëlqimi për ndërprerjen e Aneksit III të Kontratës nr.2345/23 të datës 01.06.2023 për ofrimin e shërbimeve me kompaninë NPK "Ekologjia" Sh.A. – Graçanicë, të cilën e përfaqëson drejtori ekzekutiv Dejan Dimitrijević (*Dejan Dimitrijević*).

Neni 2


Autorizohet kryetarja e Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubarić (*Ljiljana Šubarić*), që në emër të Komunës së Graçanicës ta ndërpresë Aneksin III të Kontratës nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Arsyetim

Nevoja e Komunës së Graçanicës për lidhjen e Aneksit III të Kontratës nr.2345/23 të datës 01.06.2023 për ofrimin e shërbimeve me kompaninë NPK "Ekologjia" Sh.A. - Graçanicë ishte e natyrës së përkohshme, për shkak të urgjencës dhe reagimit ndaj mirëmbajtjes dimërore të rrugëve dhe mungesës së një kontrate publike kornizë të vlefshme për këtë qëllim. Duke pasur parasysh se Komuna e Graçanicës ka lidhur Kontratë publike kornizë nr.2890/25 të datës 14.07.2025 me një operator ekonomik më të favorshëm, nevoja për vlefshmërinë e mëtejshme të Aneksit III të Kontratës në fjalë për ofrimin e shërbimeve pushon.



Kryetari i Kuvendit

Milan Dimitrijević